

RAPORT VJETOR PËR ZBATIMIN E BUXHETIT, VITI 2020

Për vitin 2020 Institucionit tonë i janë akorduar fonde buxhetore në shumën prej 239,088,500 lekë (duke përfshirë ndryshimet gjatë vitit). Ky fond është realizuar në shumën prej 231,619,654 lekë ose në masën 97%.

Më poshtë paraqesim pasqyrën përmblledhëse të realizimit të shpenzimeve buxhetore të artikujve kryesor të strukturës buxhetore;

(në lekë)

<i>Nr.</i>	<i>Art.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Plani</i>	<i>Realizimi</i>	<i>Diferenca</i>	<i>Real. në %</i>
1	600	Paga & shpenz. personeli	145,859,000	142,778,084	3,080,916	98%
2	601	Sigurime shoqerore	24,154,000	23,614,045	539,955	98%
3	602	Mallra e shërbime	27,425,500	26,133,257	1,292,243	95%
4	606	Transf.buxhetet familjare	5,550,000	5,539,603	10,397	100%
5	230	Shpenz. për rritjen e aktiveve të trupëzuara	14,700,000	12,155,460	2,544,540	83%
6	231	Shpenz. për rritjen e aktiveve të trupëzuara	21,400,000	21,399,205	795	100%
TOTALI			239,088,500	233,619,654	7,468,846	97%

- **“Paga dhe shpenzime të tjera personeli”**; në këtë artikull fondet e planifikuara janë në shumën 145,859,000 lekë dhe realizimi është në shumën prej 142,778,084 lekë, ose 98% e planit, me një tepriçë fondesh në vlerë prej 3,080,916 lekë.

Mosrealizimi vjen si shkak i mosplotësimit të strukturës së miratuar me personel prej 10-15 punonjësish gjatë vitit buxhetor.

- **“Sigurimet shoqërore & shëndetësore”**; fondet e planifikuara për vitin 2020 janë në shumën prej 24,154,000 lekë, realizimi i pritshëm i tyre është në shumën prej 23,614,045 lekë ose 98% e planit.

- **“Mallra e shërbime të tjera”**; nga fondet e miratuara në këtë artikull, në shumën prej 27,425,500 lekë, nga të cilat janë realizuar fondet në shumën prej 26,133,257 lekë ose 95% e planit.

Diferenca e mosrealizimit në këtë zë kryesisht ka ardhur si rezultat mospërdorimit total të fondit të planifikuar në nënartikullin *“Shpenzime të tjera operative”* fond i posçëm që përdoret sipas nevojave, konform VKM-së nr.741, datë 05.11.2014 ”Për përcaktimin e kushteve, kritereve të përdorimit dhe kontrollit të **fondit të posaçëm**, në funksion të veprimtarisë hetimore dhe procesit informativ të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme”.

- **“Transferim për buxhetet familjare dhe individë”**; fondet e planifikuara në këtë zë janë në shumën prej 5,550,000 lekë (përfshirë shtesën e fondit në muajin prill prej 700,000 lekë si fond i veçantë), nga të cilat janë realizuar fondet në shumën prej 5,539,603 lekë ose 100% e planit.

- **“Shpenzime për rritjen e aktiveve të trupëzuara”**; për vitin 2020 njësisë tonë i janë miratuar fonde, në shumën prej 14,700,000 lekë, parashikuar për “Blerje programi për analizim të dhënash”.

Procedura e blerjes është realizuar konform VKM-së nr.741, datë 05.11.2014 "Për përcaktimin e kushteve, kriterëve të përdorimit dhe kontrollit të *fondit të posaçëm*, në funksion të veprimtarisë hetimore dhe procesit informativ të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme". Në përfundim është lidhur kontrata me nr.1995/1, datë 17.09.2020, për vlerën totale prej 11,681,460 lekë. Detyrim i cili është likujduar plotësisht.

- "*Shpenzime për rritjen e aktiveve të trupëzuara*"; fondet e miratuara në këtë artikull janë në shumën prej 21,400,000 lekë, të detajuara për "Rikonstruksion godine për SH.Ç.B.A".

Procedura e blerjes është zhvilluar nëpërmjet faqes së Agjencisë së Prokurimit Publik është konkluduar me lidhjen e kontratës për vlerën totale prej 36,943,433 lekë.

Konform dokumenteve vërtetuese dhe justifikuese është likujduar detyrimi i faturuar nga operatori ekonomik në shumën prej 21,399,205 lekë. Diferenca e vlerës së kontratës është detyrim për vitin pasardhës.

Gjithashtu theksojmë faktin se nuk kemi detyrime të prapambetura apo të krijuara rishtazi nga viti 2020.